

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**Skema e vlerësimit të përgjigjeve**

(Orientuese)

Pjesa I- Gjuhë shqipe*Larguar*

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë

Pyetja 5 (a) 1 pikë

Cila është një nga arsyet që e nxit autoren të largohet për një ditë?

Përgjigjja e dhënë identifikon një nga arsyet e dhëna në listën më poshtë.

Shembuj:

- Përgjegjësitë që ajo ka,
- Punët, familja,
- Angazhimet,
- Shqetësimet e përditshme,
- Rutina e jetës,
- Nevoja për t'u çlodhur.

1 pikë Nëse identifikon një nga arsyet që e nxitin autoren të largohet për një ditë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 5 (b)**2 pikë**

A janë të gjithë njerëzit të të njëjtit mendim me autoren? Zbuloni në tekst një ilustrim që nënvizon një qëndrim të kundërt me idenë e saj, duke dhënë edhe mënyrën se si e kundërshton autorja këtë mendim.

Përgjigjja thekson: **JO**.

Shembuj:

- **Jo**, nuk janë të gjithë në të njëjtin mendim me autoren.

Ilustrimi:

- Një pjesë mund të mendojnë se largimi nga detyrimet është papërgjegjshmëri.
- Disa mendojnë se nuk mund t'u shmangesh detyrimeve që ke në jetë.

Mënyra si e kundërshton:

- Tërheqja për pak kohë nga detyrimet, e çlodh njeriun dhe e ndihmon atë të pushojë për të kryer më mirë detyrimet e veta.
- Çlodhja për një ditë bën që t'u përgjigjemi më mirë detyrimeve tona.
- Kjo është e nënkuptuar pas argumentit që sjell autorja: Punët, familja, angazhimet dhe miqtë një ditë mund të mbijetojnë pa ne dhe, nëse egoja jonë do të na lejonte të rrëfeshim, ato mund të bënin gjithë jetën edhe pa ne.

1 pikë Nëse shkruan *jo* dhe jep një ilustrim që e tregon këtë kundërshtim.

1 pikë Nëse tregon mënyrën sesi autorja e kundërshton mendimin e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 6 2 pikë

Identifikoni dy nga masat që merr ajo për t'u ndierë "e harruar".

Përgjigjja e dhënë identifikon dy nga masat e listuara më poshtë. Ato (masat) mund të jetë një citim i drejtpërdrejtë nga teksti ose një perifrazim.

Shembuj:

- Informon familjen,
- Fik telefonin,
- Dëgjon muzikë të mirë,
- Bën gati rrobat për largimin,
- Fik alarmin e orës.

2 pikë Nëse identifikon dy masa që merr autorja.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një masë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 7 2 pikë

Pse është kaq i rëndësishëm për autoren ky lloj largimi? Cili është arsyetimi që ajo bën për të shpjeguar veprimin e saj?

Shembuj:

Rëndësia e largimit:

- Është rifitim energjish.
- Çlodhje për t'u ripërtërirë.

Arsyetimi:

- Shkëputje për një ditë nga shqetësimet, detyrimet.
- Kemi nevojë për hapësirë.
- Kemi nevojë për të parë natyrën, jetën e gjallë.
- Të mos shqetësohemi për pyetje, probleme etj.

1 pikë Nëse tregon pse ky lloj largimi është i rëndësishëm për autoren.

1 pikë Nëse tregon arsyetimin që jep ajo (perifrazim apo i shkëputur nga teksti).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 8 **2 pikë**

Cilat janë dy ndjenja që ka nxitur autorja e kësaj pjese tek ju si lexues?

Përgjigjja e dhënë identifikon dy ndjenja që i shkakton nxënësit leximi i tekstit dhe që dëshmojnë se e ka kuptuar thelbin e tij. Këto ndjenja **mund** të jenë edhe nga lista më poshtë.

Shembuj:

- Simpati,
- Respekt,
- Mirënjohje,
- Kënaqësi,
- Frymëzim,
- Gëzimin e zbulimit të diçkaje të re,
- Etj.

2 pikë Nëse identifikon **dy** ndjenja personale.

1 pikë Nëse identifikon vetëm **një** ndjenjë personale.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 9 **3 pikë**

Zbuloni në tekstin e dhënë një paragraf përshkrues dhe shkruani dy karakteristika gjuhësore që e bëjnë atë të tillë.

Shembuj:

Secili nga paragrafët e pjesës së parë është përshkrues.

Karakteristikat:

- Renditja e veprimeve (prezenca e foljeve),
- Përdorimi i kohës së tashme të foljes,
- Gjuhë e detajit pamor, dëgjimor, e të prekurit,
- Gjuha e figurshme: enumeracionet.

2 pikë Nëse identifikon **dy** karakteristika të një paragrafi përshkrues në tekstin e dhënë, bashkë me paragrafin përkatës.

1 pikë Nëse identifikon **një** karakteristike të një paragrafi përshkrues në tekstin e dhënë, bashkë me paragrafin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim, mungon paragrafi, karakteristikat nuk i takojnë atij paragrafi ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pjesa II***Si orientohen zogjtë shtegtarë?***

Pyetja 10	A	1 pikë
Pyetja 11	C	1 pikë
Pyetja 12	B	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë

Pjesa II - LETËRSI**Migjeni*****“Kangët e pakëndueme”***

Pyetja 20 **A** **1 pikë**

Pyetja 21 **C** **1 pikë**

Pyetja 22 **D** **1 pikë**

Pyetja 23 **1 pikë**

Cili është shqetësimi kryesor i poetit në këtë poezi?

Shembuj:

- Shqetësimi kryesor i poetit lidhet me vargjet e tij, të cilat akoma nuk kanë shpërthyer nga shpirti i tij për të ngacmuar zemrat e lexuesit.
- Shqetësimi lidhet me pamundësinë për të qenë i lirë në artin e tij, për të shfaqur gjithçka ndjen dhe krijon në mënyrë të lirshme dhe pa kufizime.
- Shqetësimi lidhet me ëndrrat e poetit që marrin trajtën e vargjeve që ai nuk mund t’i shpërthejë për shkak të rrethanave penguese.
- Ai shqetësohet nëse do të mund ta thotë fjalën e tij për lexuesin (*përgjigje minimale, por e pranueshme*).

1 pikë Nëse tregon ku qëndron shqetësimi kryesor i poetit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 24 **1 pikë**

Interpretoni forcën shprehëse që mbart folja flenë në strofën I.

Shembuj:

- Poeti nuk thotë **ndodhen, janë**, por ka përdorur foljen **flenë**. Pra ende nuk janë zgjuar. Janë ende duke u përkundur brenda qenies së tij, një pjesë të krijuara e një pjesë që ndoshta do të krijohen më vonë. Mund të jenë të bukura ose të frikshme, ashtu si dhe ëndrrat.
- Shprehja zgjon tek lexuesi përfytyrime që lidhen me **gjumin, plogëshinë**, gjendjen e kundërt të zgjimit. Bëhet fjalë për **këngë** që ndodhen ende në një gjendje të tillë. Ato janë thellë qenies së tij dhe ende nuk janë zgjuar, nuk kanë dalë në dritë, nuk janë shfaqur. Presin të zgjohen.
- Përdorimi i metaforës **këngët flenë** (madje kjo shkon drejt personifikimit) ndihmon lexuesin të përfytyrojë vargje që flenë (si njerëzit) dhe kjo lidhet me pushtetin që i jep autori vargut, pasi vargjet lidhen me shpirtin. Pas gjumit ka një zgjim. Lexuesi e ndjen se autori parathotë ëndrrën e tij për një zgjim.

1 pikë Nëse shpjegon forcën shprehëse që mbart folja.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 25 (a) 2 pikë

Cili është mendimi që ka poeti për poezinë? Në cilin varg shfaqet ai?

Shembuj:

Mendimi:

- Arti, poezia duhet të jenë të lira, pa kufizime.

Vargu:

- *m'u këndue pa frigë e pa zori*

1 pikë Nëse tregon mendimin që ka poeti për poezinë.

DHE

1 pikë Nëse identifikon vargun ku shfaqet ky mendim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 25 (b) 1 pikë

Lexoni me kujdes vargun: por kur t'i vijë dita të gjitha ka me i qitun. Sipas mendimit tuaj, cila është dita që përfaqëson poeti?

Shembuj:

- Dita kur të ndihet i lirë, i pakufizuar, ku çdo gjë të dalë prej tij *pa frigë dhe zori*.
- Dita e mendimit të lirë dhe e fjalës së lirë.

1 pikë Nëse tregon ditën që përfaqëson përmes vargut të dhënë poeti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigje në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 26 **2 pikë**

Me çfarë e përqsas veten poeti? Shpjegoni forcën e përfytyrimit që krijohet nga kjo analogji.

Shembull:

- Me vullkanin.

Shpjegimi**Shembuj:**

- Ashtu si vullkani duket i qetë dhe sikur fle, ashtu ndihet edhe poeti në këto çaste. Por po ashtu si vullkani që kur zgjohet, shpërthen dhe me forcën e tij merr përpara dhe shkatërron gjithçka, ashtu do të jetë edhe zgjimi i poetit.
- Imazhi që krijohet është ai i një mase vullkanore që zien së brendshmi, ashtu i padukshëm, dhe në pikun e zierjes së tij, shpërthen duke marrë me vete e duke përvëlur gjithçka që gjen përpara.
- Vargjet e poezisë (fjala e lirë) janë llava e vullkanit që buron nga nxehtësia e një shpirtiti që zien.

1 pikë Nëse identifikon vullkanin.

DHE

1 pikë Nëse zberthen nëntekstin e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 27 **3 pikë**

Mbi ç'figurë stilistike ngrihet vargu i fundit i kësaj poezie? Si do ta interpretonit nëntekstin që mbart ky varg?

Shembull:

Figura:

antiteza: *vorri-djepi*.

Interpretimi:

Shembuj:

- Ka një kundërvënie të fuqishme. Poeti është krijuesi i poezisë së tij, i ka sjellë në jetë vargjet e saj, i ka përkundur brenda tij, por nëse nuk do vijë dita e tyre, ai vetë do të jetë varri i tyre. Ato mund të mos shfaqen kurrë, për shkak të pamundësisë së tij fizike apo realitetit. Ndajfolja **ndoshta** e thekson këtë dilemë të poetit dhe e shfaq edhe më të fortë dhimbjen.
- Nënteksti i vargut lidhet me shqetësimin e poetit nëse fjala e tij do të mund të gjejë dëgjuesit e saj apo djepi që i lëkund, do të bëhet edhe varri i tyre. Pra, vargjet do të lindin (krijohen) nga poeti dhe do të vdesin (do të mbeten) sërish brenda tij.
- Vargjet mbartin një ngarkesë të madhe, pasi ngjashmëritë e ideve të çojnë te djepi që lëkundet plot dashuri, tek fakti që ai djep mban brenda dhimbjen e krijimit, gjë që lidhet me vuajtjen e dashurinë e poetit gjatë procesit krijimit.

1 pikë Nëse identifikon figurën stilistike.

DHE

1 pikë Nëse interpreton nëntekstin e vargut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Viktor Hygo**“Katedralja e Parisit” (fragment)**

Pyetja 28 C 1 pikë

Pyetja 29 D 1 pikë

Pyetja 30 B 1 pikë

Pyetja 31 (a) 2 pikë

Cila është gjendja shpirtërore e Kuazimodos në fragment? Si shfaqet ajo përmes hollësive të të folurit? Zbuloni një rast, për të ilustruar përgjigjen tuaj.

Shembuj:Gjendja shpirtërore:

- e trishtuar,
- e rëndë, por pa shpërthime,
- e përvuajtur,
- e brengosur,
- e hidhëruar,
- e pikëlluar,
- plot mërzitje.

Si shfaqet:**Shembuj:**

- Shfaqet përmes **fjalëve** të Kuazomodos.
- Pashirmave, lutjeve, krahasimeve që përdor Kuazimodo.

Ilustrime:

- *Fatkeqësia ime është se i shëmbëllez ende tepër njeriut. Do të doja të isha një kafshë, siç është kjo dhia.*

- *Oh, ju lutem, - tha ai përvajshëm, - vazhdojeni këngën dhe mos më dëboni!*

“Oh, pse nuk jam dhe unë prej guri siç je ti!”

1 pikë Nëse tregon gjendjen shpirtërore të Kuazimodos.

DHE

1 pikë Nëse tregon si shfaqet ajo.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 31 (b)**2 pikë**

Cili është **thelbi** i natyrës së Esmeraldës? Shpjegoni përgjigjen tuaj, duke e mbështetur atë me një ilustrim nga fragmenti.

Shembull:

- Esmeralda është në thelb natyrë e dhembshur. Ajo edhe pse ka frikë nga Kuazimodo, nuk e përbuz atë për shëmtinë e tij, madje asaj i vjen keq për të dhe nuk do që ta hidhërojë.

Ilustrimi:

- *nuk deshi ta hidhëronte atë dhe e vazhdoi baladën, ndonëse duke u dridhur.*
- *qortonte vetveten se mirënjohja e saj kundrejt tij nuk ishte e mjaftueshme.*

1 pikë Nëse tregon thelbin e natyrës së Esmeraldës.

DHE

1 pikë Nëse identifikon një ilustrim që mbështet shpjegimin e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 32 2 pikë

Zbuloni tonin me të cilin është thënë fjalia e fundit e këtij fragmenti. Interpretoni nga buron ky lloj toni i komunikimit?

Toni:

Shembuj:

- trishtim,
- pikëllim,
- dëshpërim.

Interpretimi

Shembuj:

- Ky lloj toni buron nga dhimbja e thellë. Kuazimodo po vuan thellësisht dashurinë e tij të pashpresë që ka për Esmeraldën. Fakti që ajo është kaq e largët me të, bën që ai të jetë në atë shkallë dëshpërimi, sa të dëshirojë të jetë prej guri (si statuja e katedrales), vetëm që të mos vuajë kaq shumë.
- Pasthirrma që ai lëshon, shfaq pikërisht këtë dëshpërim, vuajtje të thellë, të cilën nuk po e përballon dot. Këtu buron dëshira e tij që të jetë prej guri.
- Statujat janë të ftohta, të akullta, të pandjeshme. Kuazimodo dëshiron të jetë i tillë, pikërisht që të mos përjetojë këtë shkallë dhimbjeje, vuajtjeje. Këtu e ka burimin toni i përdorur në këtë fjali.

1 pikë Nëse identifikon tonin.

DHE

1 pikë Nëse interpreton nga buron ky lloj toni.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nëse nxënësi gjen tonin dhe konstaton, por pa e zbërthyer se nga buron, përgjigjja do të vlerësohet me **1 pikë**.

P.sh: Tonet e dëshpëruara burojnë nga dhimbja (konstatim, por nuk ka interpretim të plotë).

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 33 **1 pikë**

Në paragrafin e dytë, narratori shprehet për Esmeraldën: E shkreta! Çfarë nënkupton kjo?

Shembuj:

- Esmeralda është e vetmuar, e izoluar, e braktisur. Në këtë situatë ajo nuk e kupton se i vetmi mik i saj është Kuazimodo. Këtu buron keqardhja e narratorit.
- Situata është paradoksale. Esmeralda vuan për Febysin dhe nuk e kupton se i vetmi mik që ka është Kuazimodo. Kjo shkakton keqardhjen e narratorit.
- I dhimbset Esmeralda, jo vetëm për shkak të situatës ku ndodhet, por më shumë për shkak të natyrës së saj naive e të pafajshme, në kushtet e një bote të egër.

1 pikë Nëse tregon çfarë nënkupton fjalia e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.

Pyetja 34 3 pikë

Komentoni fjalinë, duke shpjeguar funksionin e figurave letrare në përcjelljen e imazhit.

Duke u mbyllur plagët e saj të shpirtit, fytyra e saj nisi të rrëzëllente përsëri nga bukuria, por nga një bukuri më hijerëndë dhe më e qetë se përpara.

Koment:

Shembuj:

- Esmeralda po rikthehet në gjendjen e saj të mëparshme. Mbyllja e plagëve të shpirtit, të cilën autori e shpalos përmes metaforës, rikthen bukurinë fizike, e cila nuk është më si më parë, edhe kjo e dhënë figurativisht përmes **metaforës** - *nisi të rrëzëllente*. Edhe vetë personazhi, si karakter, nuk është më i mëparshmi. **Epitetet**: *hijerëndë dhe e qetë*, theksojnë pikërisht këtë zhvillim të karakterit.
- Paralelisht me bukurinë fizike, sjellë përmes **metaforës** (*nisi të rrëzëllente përsëri nga bukuria*), autori zbulon rilindjen shpirtërore të saj, sërish përmes **metaforës** (*duke u mbyllur plagët e saj të shpirtit*). Gjithsesi, në këto momente Esmeralda duket se nuk është thjesht ajo e para, ajo është pjekur e forcuar si karakter (bukuri *më hijerëndë, më e qetë- epitete*).

Figurat letrare që mund të shfrytëzohen gjatë komentit, janë:

Epitete:

- bukuri më **hijerëndë** më **e qetë**.

Metafora:

- *Duke u mbyllur plagët e saj të shpirtit*
- *fytyra e saj nisi të rrëzëllente përsëri nga bukuria*

1 pikë Nëse jep të qartë imazhin e krijuar.

DHE

2 pikë Nëse imazhi zërthehet përmes dy llojeve të figurave: metaforave dhe epiteve.

OSE

1 pikë Nëse imazhi zërthehet **vetëm** përmes metaforave ose **vetëm** përmes epiteve.

0 pikë Nëse zbulon figurat, por pa iu referuar imazhit të plotë, përgjigjet gabim ose nuk jep asnjë përgjigje.

Shënim:

Nxënësi e artikulon përgjigjen në mënyrë individuale, por në të gjitha rastet ajo duhet të dëshmojë se e ka kuptuar thelbin e tekstit dhe të pyetjes.